

PKR.nr.556/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykata e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, Suzana Çerkini me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.D. nga P., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.457/2016, të datës 21.09.2016, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 02.12.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri dhe të pandehurit A. D., të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. D., i biri i M. dhe nënës H., e vajzërisë A., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin K. Komuna P., tani me vendbanim në rr.”...”, nr., ka të kryer shkollën e mesme, përgjegjës i njësitit në Njësinë e Transportit në Burgun e Lipjanit, i martuar babë i shtatë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me numër personal *numër personal...*,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, ka përdor armën në shkelje të ligjit të zbatueshëm për armët, në atë mënyrë që me datë 21.08.2016 rreth orës 10:50, në oborrin e shtëpisë së tij në lagjen “K.” në P., gjatë një ahengu familjar me rastin e fejesës së djalit të tij, ka shtënë tri herë në drejtim të tokës me armën e tij zyrtare të tipit Glock 9x19 mm, modeli 17, prodhim i Austrisë me nr. serik 13429, ndërsa policia në vendin e ngjarjes ka gjetur tri gëzhoja,

- me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 45,47, 73, 74, 75 par.1 pika 1.3 të KPRK dhe nenit 248, 365 dhe 366 të KPP i shqipton,

DËNIM ME BURG

Në kohëzgjatje prej **1 (një) muaj**, ashtu që me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burg i zëvendësohet me dënim me gjobë, në shumë prej **300 (treqind) euro**,

I pandehuri është i obliguar që gjobën e lartshënuar t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë, në të kundërtën gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një muaji,

Arma, revole e tipit Glock 17 e kal.9x19mm si dhe municioni i sekuestruar, t'i dorëzohet Shërbimit Korrektues të Kosovës,

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP.I.nr.457/2016, të datës 21.09.2016, ka akuzuar A. D., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas adminsitrimin të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor, t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 02.12.2016, në të cilën i pandehuri, i vënë në dijeni të plotë për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, vullnetarisht pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë, për çka i njëjti deklaroi se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, është plotësisht i vetëdijshëm për gabimin e bërë, por i njëjti deklaroi se kjo ka qenë për shkak të emocioneve që nuk ka arritur t'i ndal me rastin e martesës së djalit të tij, pas pesë vajzave dhe, meqenëse armën e ka pasur me vete dhe atë me leje, pasi që punon si zyrtar në Njësitin për Transportin e të burgosurve, për çka shpreh pendimin e tij të thellë dhe premtori gjykatës që edhe në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale të natyrës së tillë apo të ngjashme, andaj në fund ka lutur gjykatën që ti shqiptojë një dënim sa më të butë, duke marrë parasysh pranimin e fajësisë dhe

pendimin e thellë, si dhe gjendjen e rëndë ekonomike, duke shtuar se është mbajtës i familjes nëntë anëtarëshe jeton me vetëm me 450 euro të ardhura, prej të cilëve tre fëmijë i ka studentë.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, edhe prokurori i shtetit shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi nga i njëjti është bërë në përputhje me provat e bashkangjitura në aktakuzë, i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes së dënimit të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe ti shqiptohet një dënim sa më i butë.

Pas deklarimit të të pandehurit, se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet dhe, pajtimin për pranimin e fajësisë nga prokurori i shtetit, gjykata gjithashtu e aprovoi fajësinë nga i pandehuri, pasi është bindur se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të pandehurit dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmbanë akuzat, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK dhe, i shqiptoi dënim të paraparë ligjor të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pendimin e shprehur, premtimin e dhënë se nuk do t'a përsërisë veprën penale, paraqitjen korrekte dhe të sinqertë në gjykatë, gjendjen e dobët ekonomiko-financiare, i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes shumë antarëshe, si dhe faktin se nuk zhvillohet procedurë penale për asnjë vepër tjetër penale, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj, i shqiptoi dënim të zbutur me burgim, të cilin me pajtimin e të njëjtit ia zëvendësoi me gjobë, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund dhe, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.556/16, me datë 02.12.2016**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.